



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

*Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;*

*E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al*

Nr. 65/9Prot.

Tiranë, më 30.06.2018

**V E N D I M**

**Nr. 75, Datë 30.06.2018**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR "SHEFQET NDROQI"  
TIRANË**

**"MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË TË  
VEPRIMTARISË EKONOMIKO - FINANCIARE**

**Për periudhën nga data 1.01.2016 deri më datën 31.12.2017**

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi" rezultoi që, ky subjekt ka nevojë për përmirësime të mëtejshme në menaxhimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, duke njohur në mënyrë të integruar dhe zbatuar aktet ligjore konform kërkesave në fuqi, duke forcuar dhe konsoliduar sistemet e kontrollit të brendshëm, për një përdorim me eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të akorduara buxhetore .

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**VENDOSA**

**I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të veprimtarisë ekonomiko – financiare, të ushtruar në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë, sipas programit të auditimit nr.65/1 prot, datë 22.01.2018, të ndryshuar për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017. Auditimi u krye nga data 25.01.2018 deri më 13.04.2018.**

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

### III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

#### A. MASA ORGANIZATIVE

##### 1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

###### **Gjetje nga auditimi 1**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, me shkresën nr.1211/7, datë 16.05.2016 ka rezultuar se nuk janë zbatuar plotësisht të gjitha rekomandimet, ku nga 30 masa organizative të lëna për zbatim, janë zbatuar plotësisht 11, janë zbatuar pjesërisht 11 dhe janë në proces zbatimi 8. Masat e lëna për shpërbllim demi të cilat janë 2 në shumën 35,267,909 lekë janë në proces gjykimi (janë çelur paditë dhe janë në shkallën e parë të gjykimit). Ndërsa 4 masat e lëna për fondet e përdorura pa efektivitet rezultojnë pjesërisht të zbatuara (*Më hollësisht trajtuar në faqet 5-6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe Aneksin 1*).

**Niveli i riskut:** i lartë

###### **Rekomandim1**

*-Të merren masat administrative e ligjore për zbatimin plotësisht të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. Nr.1211/7, datë 16.05.2016, të rezultuara në proces dhe pjesërisht.*

*-Nga Autoriteti Kuntraktor për masat e shpërbllimit të dëmit të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit.*

*Në vazhdim*

##### 2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

###### **Gjetje nga auditimi 2**

Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimin dhe funksionimin e strukturave drejtuese, për vendimet dhe zbatimin e tyre rezulton se:

-Struktura organizative dhe organigrama e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” me protokoll nr. 3797 datë 14.07.2016 dhe struktura analitike me protokoll nr. 1208/1 prot., datë 03.03.2017 janë miratuar vetëm nga Ministri i Shëndetësisë dhe jo edhe nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës

-Gjithashtu, rregullorja për funksionimin e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë nr. 516/1 prot., datë 16.08.2016 është miratuar vetëm nga Drejtori por nuk është e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 823 datë 11.06.2008 “Për kthimin e Spitalit Universitar të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" në Spital Universitar "Shefqet Ndroqi" pika 4 e përditësuar me VKM nr. 658 datë 10.11.2017 për “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, pika 2

-Struktura ndihmëse e Komisionit Mjekësor Spitalor nuk ka përmblusur detyrimet për të cilat është krijuar si: *“Hartimi i programeve të vitit pasardhës; programeve të punës së shërbimit mjekësor, hartimi i projekt-buxhetit, përcaktimi i strukturës organizative të shërbimeve mjekësore etj* në kundërshtim me statutin e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës me nr. 693/4 datë 28.08.2006 dhe nr. 5637 datë 28.08.2006, Kreu II, pika 4.3, në fuqi.

-Janë marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Protokoll Arshivës nga ana e Spitalit Universitar, bazuar në ligjin nr. 9154 datë. 06.11.2003 neni 23 për Arkivat në Republikën e Shqipërisë, por nga auditimi janë evidentuar mini arkiva të krijuara në zyra të veçanta të administratës.

-Urdhrat e dala nga Titullari, kanë mangësi në formulim, në përcaktimin e bazës ligjore, në interpretim dhe në përmbajtje, bazuar në nenin 99 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” (Më hollësisht trajtuar në faqet 6-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Niveli i riskut:** i lartë

#### **Rekomandimi 2**

-Nga Drejtorja e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” të merren masa për të ngritur një sistem të mirëfilltë dhe efikas për monitorimin tekniko-administrativ, duke evidentuar problematika, përgjegjësi dhe rekomandime me afate konkrete brenda kompetencave të Komisionit Mjekësor Spitalor të përshkruara në Rregulloren dhe statutin e Spitalit, ose të përcaktohen detyra të reja për të cilat Komisioni të ketë kompetencë.

-Struktura e arkiv protokollit të funksioneve si një strukturë e vetme për gjithë veprimtarinë e spitalit, sipas kërkesave të ligjit mbi arkivat dhe procedurave të dala në zbatim të tij dhe dokumentacioni shkresor i dalë nga administrata të ketë të gjithë elementet e domosdoshëm të një dokumentacioni shkresor, konform kërkesave të Kodit të Procedurave Administrative .

**Menjëherë**

### **3. Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe auditimi i shpenzimeve administrative.**

#### **Gjetje nga auditimi 3**

Nga SUSHN në projektbuxhetin e paraqitur për vitet 2016 dhe 2017, nuk janë plotësuar kërkesat shtesë mbi tavanet e miratuar, të argumentuar dhe të vlerësuar në vlerë monetare, dokument bazë për përfitim fondesh mbi tavanet e miratuar për institucionin përkatës dhe pjesë e diskutimeve të shifrave të projektbuxhetit, veprim që bie në kundërshtim me udhëzimet e miratuara të Ministrisë së Financave: Udhëzimi nr.4, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e PBA për Vitin “2017-2019” dhe udhëzim nr.8, datë 27/02/2015 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018” në germa h (Më hollësisht trajtuar në faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Niveli i riskut:** i lartë

#### **Rekomandimi 3**

Nga SUSHN të merren masa që nevojat e paraqitura në projektbuxhetin e vitit pasardhës duhet të jenë jo vetëm për limitet e miratuara me vendim të KM dhe akorduar për subjektin, por dhe për nevojat reale të funksionimit normal të SUSHN. Për këtë duhet domosdoshmërisht plotësimi i formateve të kërkesave shtesë, konform procedurës dhe argumentimit, pasqyruar në udhëzimet e Ministrisë së Financave “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”. Pasqyrimi i nevojave për fonde gjatë viteve ushtrimore, referuar shkresave përkatëse është proces i pamjaftueshëm, në momentin kur fondet buxhetore janë të miratuara me ligjet vjetore të buxhetit për çdo institucion dhe këto kërkesa duhet të bëhen vetëm në rastet e nevojave për fonde emergjente dhe të pamundura për tu planifikuar në kohën e hartimit të PBA.

**Në çdo rast të hartimit të PBA**

#### **Gjetje nga auditimi 4**

Për vitet 2016 dhe 2017 nga SUSHN nuk janë paraqitur raporte monitorimi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kundërshtim me ligjin për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjin për MFK. Këto raporte paraqiten çdo tre muaj, por nga SUSHN nuk janë paraqitur jo vetëm raportet progresive të monitorimit për vitet përkatëse por dhe raportet vjetore të monitorimit, përgjegjësi kjo e Nëpunësit Autorizues(titullar i institucionit) në zbatim të nenit 65 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Niveli i riskut:** i mesëm

#### **Rkomandim 4**

*Nisur nga fakti i rëndësisë së Raporteve të Monitorimit të cilat duhet të jenë të publikuara dhe në faqen web të SUSHN jo vetëm për procesin e realizimit të objektivave dhe treguesve buxhetorë, por dhe për efekt të transparencës me publikun, nga titullari i SUSHN në cilësinë e nëpunësit autorizues të spitalit, të merren masa që ky proces të ndiqet, të monitorohet dhe hartohen raportimi i treguesve institucional në formën e raporteve të monitorimit, kundrejt formateve dhe të gjitha elementëve të vendosur nga Ministria e Financave në udhëzimet përkatëse, për çdo periudhë të përcaktuar në legjislacionin sa më sipër dhe këto raporte të publikohen konform kërkesave ligjore.*

**Vazhdimisht**

#### **4.Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.**

##### **Gjetje nga auditimi 5**

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave janë konstatuar 9 raste të personave të punësuar rishtazi në vitin 2016, ku për procedurën e marrjes në punë nuk figuron miratimi i Ministrit në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë, “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore” ku punësimi është kryer sipas urdhrave të brendshme.

-Në listë pagesat e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” ka mos përshtatje të mënyrës së llogaritjes së vjetërsisë nga një listë pagese në tjetrën edhe pse brenda të njëjtës periudhë një vjeçare, ka vonesa në raportimin e vjetërsisë për çdo punonjës në muajin përkatës në të cilin ai përmbush vitin. Nuk shënohen në mënyrë sistematike lëvizjet në librezën e punës, nuk bëhet përditësimi në kohë reale i vjetërsisë në punë.

-Nuk është bërë përditësimi i arsimimit dhe kualifikimit profesional i cili influencon nivelin e llogaritjes së pagës së grupit. I gjithë konfuzioni i krijuar në komponentët e pagës ka ndikuar në ndryshimin e niveleve të pagave duke sjellë diferenca pozitive dhe negative, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1035 datë 27.11.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 555, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosura”, i ndryshuar.

-Nga auditimi i 15 dosjeve personale janë konstatuar parregullsi në lidhje me vlerësimet e kryera për vitet 2016-2017 të cilat mungojnë në të gjitha dosjet e audituara, në formën e kontratës së punës ku në disa prej tyre mungojnë elementët përbërës të pagës (në disa raste elementët e pagës bashkëngjiten si vërtetim në kontratën e punës), si dhe mungon referenca në kontratën kolektive të punës në kundërshtim me Kodin e Punës, neni 21, pika 3/ë, 3/g.

-Nga auditimi i strukturës, mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Shërbimit të Urgjencës Para-spitalore rezulton se organizimi i saj është në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Shërbimit të Urgjencës Mjekësore Para-spitalore nr. 516/5, datë 15.11.2016, Kreu III Organizimi i shërbimit. Kjo strukturë nuk funksionon në referencë të VKM nr. 33, datë 20.01.2016 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016” dhe VKM nr. 18 datë 11.01.2017 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017” dhe Urdhrit nr. 38, nr. 639, datë 01.02.2016 të Ministrit të Shëndetësisë “Për transferimin e personelit të Shërbimit të urgjencës Mjekësore, Tiranë, pasi pagesa e punonjësve të Shërbimit të Urgjencës Para-spitalore kryhet nga fondi i pagave të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe jo me financim nga FSDKSH ndërsa mënyra e

organizimit koordinohet nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore të Tiranës (Më hollësisht trajtuar në pikën faqet 13 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Niveli i riskut:** i mesëm

#### **Rekomandimi 4**

-Nga Sektori i Financës dhe të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, të merren masa që të ri-strukturohet mënyra e përlogaritjes së pagave për çdo të punësuar në Spital duke rritur transparencën në afrimin e informacionit përkatës për të gjithë komponentët e pagës, duke shënuar vitet e punës në numër dhe në vlerë, pozicionin e punës sipas emërimit përkatës të gjithsecilit, pagën e grupit sipas arsimimit përkatës të gjithsecilit, mënyrën e llogaritjes së orëve shtesë dhe të gjitha shtesave dhe ndalesave të cilat duhet të paraqiten në listë pagesë, duke qenë në përputhshmëri të plotë edhe me bazën referuese ligjore.

-Të merren masa që të bëhet përditësimi i regjistrit të punonjësve si dhe librezave të punës me lëvizjet përkatëse dhe periudhat përkatëse për çdo të punësuar si edhe plotësimi i dosjeve për çdo të punësuar sipas inventarit të dosjes.

-Nga Drejtorja e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa që urgjenca paraspitalore të mos jetë pjesë e funksioneve të SUSHN, por i një institucioni tjetër qendror i menaxhimit të urgjencave (ekzistues), për të ngritur një sistem të mirëfilltë dhe efikas menaxhimi tekniko-administrativ të urgjencës paraspitalore, duke evidentuar problematika, përgjegjësi dhe rekomandime për koordinimin e punës në këtë njësi me stafin aktual të punësuar.

**Menjëherë**

**5.Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.**

#### **Gjetje nga auditimi 6**

Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se:

a-Amortizimi i aktiveve të trupëzuara për vitet 2016 dhe 2017 është llogaritur mbi vlerën e aktiveve në çelje të ushtrimit pra me gjendjen e aktiveve në fillim viti dhe jo në fund viti, duke përjashtuar nga amortizimi lëvizjen e aktiveve gjatë vitit (amortizimin e aktiveve të hyra nga momenti i hyrjes dhe amortizimin e aktiveve të dala apo të nxjerra jashtë përdorimit në momentin e daljes), veprim që bie në kundërshtim me SKK 5 si dhe pikën 9 të udhëzimit nr.14, date 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisve që varen prej tyre si dhe te njësisve te menaxhimit, zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj” të ndryshuar.

b-Nga hartuesit e pasqyrave financiare në amortizimin e llogaritur mungojnë kategoria e pajisjeve informatike, kompjuterike e elektronike e cila e ka llogaritjen ndryshe nga zërat e tjerë të aktiveve në masën 25 %, Ky grup është përfshirë tek makineritë e pajisjet operacionale, instrumente e vegla me normë amortizimi 5.8 %, veprim që bie në kundërshtim me udhëzimin nr.14, date 28.12.2006 pika II.1

Theksojmë se nga grupi i auditimit ishte e vështirë të përcaktohej efekti në pasqyrat financiare pasi amortizimi nga hartuesit e pasqyrave financiare nuk llogaritej zë më zë, por në total grupimi, veprim që bie në kundërshtim me udhëzimin nr.14 date 28.12.2006, të ndryshuar.

c-Gjithashtu në SUSHN mungon mbajtja e një regjistri të Aktiveve me të gjitha cilësimet sipas pikës 30 të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve të njësisë në sektorin publik”, të ndryshuar.

d-Në SUSHN nga krahasueshmëria e listës së nxjerrjes jashtë përdorimit të AQT për vitin 2016 dhe regjistrimeve kontabël përkatëse për to, rezultoi se nxjerrja jashtë përdorimit është bërë me vlerën fillestare pa i zbritur AQT të nxjerra jashtë përdorimit amortizimin e

akumuluar (pra me vlerën e mbetur) veprim që bie në kundërshtim me vlerësimin e aktiveve në pikën 90 pika c të udhëzimit 30 datë 27.12.2011, të ndryshuar.

e-Referuar auditimit të bankës për vitin 2016 rezultoi se nga SUSHN me ush nr.678, datë 14.10.2016 është likuiduar S.A. shpk për projektimin e sistemit të kondicionimit në zbatim të kontratës 462/14 datë 16.09.2016. Referuar kontabilizimit të shumës rezultoi se shuma sa mësipër është përfshirë në AQT dhe jo në AQPT kategori në të cilat përfshihen projektet. Mbi këtë bazë amortizimi i kësaj shume (që ka filluar në vitin 2017) në një kohë që duhet të fillonte që në vitin 2016 në muajin tetor, është përfshirë në AQT në kategorinë ndërtesa dhe është llogaritur me 1 % veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 22 pika 4.

f-Në SUSHN për vitin 2017 nga auditimi i listës së nxjerrjes jashtë përdorimit të AQT dhe regjistrimeve kontabël përkatëse në vitin 2017, rezultoi se nxjerrja jashtë përdorimit e vitit 2017 nuk është pasqyruar në veprimet kontabël as dhe në pasqyrat financiare tek formati 6 “Gjendja dhe ndryshimi i AQ”, veprim që bie në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011, të ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në faqet 22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Niveli i riskut:** i lartë

### **Rekomandimi 6**

-Nga sektori i financës së SUSHN të llogaritet amortizimi i aktiveve me gjendjen e aktiveve në fund të vitit ushtrimor, duke llogaritur amortizimin dhe për aktivet e hyra gjatë vitit sipas periudhës koresponduese në përdorim të aktivitetit. Gjithashtu pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike të ndahen nga kategoria e pajisjeve operationale, makinerive dhe instrumenteve dhe të llogariten me përqindjet e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.

-Nga sektori i financës i SUSHN të hartohet regjistri i aktiveve me të gjitha cilësimet e përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave “Mbi menaxhimin e aktiveve të njësisë në sektorin publik”.

-Nga sektori i financës i SUSHN në vijim të kryhen veprimet kontabile korrigjuese të AQT për nxjerrjet jashtë përdorimit gjatë vitit 2016, të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit me vlerën fillestare pa i zbritur amortizimin e akumuluar, si dhe të regjistrohen në kontabilitet veprimet kontabël të nxjerrjes jashtë përdorimi të miratuar dhe realizuar në vitin 2017.

-Nga sektori i financës të kryhen veprimet korrigjuese në pasqyrat pasardhëse të AQPT (projekte) të cilat janë regjistruar në kontabilitet si AQT dhe të llogariten amortizimet me përqindjet e përcaktuara në ligj dhe sipas metodës lineare.

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 7**

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitet 2016 dhe 2017 ka rezultuar se SUSHN ka një numër të konsiderueshëm të furnitorëve të kontraktuar për këto vite të rezultuar të pa likuiduar gjatë vitit dhe deri në fund të vitit. Gjithashtu në shumën 54,384,311 lekë për "furnitorë të vitit 2016 përfshihen dhe shuma prej 6,156,534 lekë detyrime për borxhe të prapambetura para vitit 2013 dhe të pa çelura nga Ministria e Financave (të pa likuiduara deri në fund të vitit 2016) pavarësisht se këto borxhe kanë qenë të përfshira në listën e identifikuar të borxheve të vjetra, por të pa likuiduara pasi nga Ministria e Financave nuk janë çelur fonde. Duke qenë se si gjatë vitit 2016 dhe vitit 2017 borxhet e vjetra janë likuiduar me fondet e çelura për kryerjen e funksioneve të SUSHN, fonde që aktualisht kanë qenë të pamjaftueshme për vetë funksionimin e SUSHN, janë krijuar borxhe të reja të vitit të cilat ngarkojnë padrejtësisht likuidimet në vitin pasardhës. Shifrat e detyrimeve të vjetra dhe të reja për një periudhë 4 vjeçare referuar auditimit janë :

*në lekë*

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2014</b>	<b>Viti 2015</b>	<b>Viti 2016</b>	<b>Viti 2017</b>
Detyrimet e vitit	29,286,114	37,233,162	48,227,777	50,768,775

Detyrimet para 31.12.2013	21,959,580	20,519,006	6,156,534	242,490
<b>Detyrimet total</b>	<b>51,245,694</b>	<b>57,752,168</b>	54,384,311	<b>50,820.466</b>

-Referuar informacionit të vendosur bashkëlidhur pasqyrave financiare ka rezultuar se SUSHN përveç numër të konsiderueshëm të furnitorëve të kontraktuar për vitin 2016 dhe 2017 të rezultuar të pa likuiduar gjatë vitit dhe deri në fund të vitit, përfshihen dhe faturat e OSHEE për vitin 2016 si dhe faturat e energjisë elektrike për muajt nëntor 2017 për tre kontrata në vlerën 893,303 lekë dhe faturat e ujit për muajt Korrik, Shtator, Tetor, Nëntor 2017 në shumën 3,007,380 lekë pagesa të cilat gjenerojnë kamat vonesa dhe ku në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar janë klasifikuar si pagesa prioritare dhe si të tilla janë pagesa që duhet të kryhen në radhë të parë.

-Mbetja e gjendjes debitore në fund të vitit ka rezultuar dhe për faktin e marrjes përsipër e angazhimeve më shumë se fondet e çelura gjatë vitit përkatës, fenomen i konstatuar si në vitet 2016 dhe 2017, veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar nenet 50,51 (Më hollësisht trajtuar në faqet 22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Niveli i riskut:** i lartë

#### **Rekomandimi 7**

*-Nga ana e SUSHN të merren masa që të ndalohen praktikat e kontraktimit të shërbimeve dhe mallrave për nevojën e funksionimit normal të institucionit, tej limiteve të fondeve të miratuara me ligjet vjetore të buxhetit, si dhe tej limitit të të ardhurave të çelura në degën e thesarit, në mënyrë që të mos krijohen detyrime të institucionit kundrejt kontraktorëve, që në mënyrë të pa drejtë kanë ngarkuar shpenzimet e vitit pasardhës.*

*-Nga SUSHN të realizohen likuidimet e faturave konform kërkesave ligjore për afatet e likuidimit si dhe atyre të përcaktuara në kontratat e kontraktuara.*

*-Nga sektori i financës brenda limiteve mujore të likuiditetit të miratuar, të respektohet radha e pagesave sipas listimit të pagesave prioritare të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit.*

#### **Vazhdimisht**

#### **Gjetje nga auditimi 8**

-Nga auditimi i kryerjes së inventarizimit të AQ rezultoi se një pjesë e mirë e punonjësve të cilët janë caktuar në komisionet e inventarizimit janë me përgjegjësi materiale në sektorët ku ato janë caktuar për të kryer inventarë, duke përbërë kështu konflikt interesi, veprim i cili bie në kundërshtim me pikën 82 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar.

-Gjithashtu nga auditimi për inventarizimin e aktiveve për vitin 2017 rezultoi se janë ngritur të njëjtat grupe me të njëjtët punonjës për të kryer inventarizimin si në vitin 2016, veprim që bie në kundërshtim me pikën 84 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 të ndryshuar.

-Për të dy vitet e audituara komisionet e inventarizimit në asnjë rast nuk kanë mbajtur procesverbal me përgjegjësit e materiale, për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit dhe për materialet e asgjësuar nuk është bërë fletë dalja nga përgjegjësi material e cila duhet ti bashkëlidhej praktikës për asgjësim, në mënyrë që të hiqen nga kartelat e magazinës kjo sasi dhe vlerë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” me ndryshim, për inventarizimin pika 83.

-Në SUSHN nuk ka dokument të që të vërtetojë se AQT të llogarisë 212 “ Ndërtime dhe rikonstrukcione” janë në pronësi apo në administrim të këtij spitali. Theksojmë se SUSHN nuk ka vazhduar procesin e regjistrimit të pronave në ZVRPP, mbas hartimit të plan rievimeve dhe dokumentacionit kryesor të përgatitur dhe të domosdoshëm për regjistrim. Pra

nuk është aplikuar në ZVRPP për të çertifikuar pronat në pronësi apo administrim të institucionit (*Më hollësisht trajtuar në faqet 22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i mesëm

#### **Rekomandimi 8**

*-Nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i SUSHN, në procesin e krijimit të komisioneve për inventarizimin e AQT, të kihet në konsideratë kërkesat e akteve në fuqi në lidhje me konfliktin e interesit si dhe të zbatohet kriteri i ndryshimit të komisioneve nga një vit buxhetor në tjetrin për të rritur efektshmërinë e punës së tij. Gjithashtu të mbikëqyret puna e komisioneve për të zbatuar hap pas hapi gjithë procesin e kryerjes dhe dokumentimit të inventarizimit, përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.*

#### **Vazhdimisht**

*- Nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i SUSHN të realizohet procesi i regjistrimit të pronave në ZVRPP referuar dokumentacionit të përgatitur dhe të domosdoshëm për regjistrim.*

#### **Menjëherë**

### **6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike dhe lidhjen e kontratave.**

#### **Gjetje nga auditimi 9**

Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit me objekt “*Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore*”, me vlerë të lidhjes së kontratave 8,886,538 lekë, 3 procedurave të prokurimit me objekt “*Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet)*” me vlerë të kontratave të lidhura në shumën 23,406,501 lekë dhe 5 procedurave të prokurimit me objekt “*Marrje e dy kaldajave me qira për ngrohje me lëndë djegëse-Pellet*” me vlerë kontratash të lidhura në shumën 24,107,342 lekë për periudhën objekt auditimi është konstatuar se:

-Në 1 rast, Argumentimi i fondit limit është kryer pas nxjerrjes së urdhrit të prokurimit dhe pas datës së zhvillimit të prokurimit në kundërshtim me nenin 9 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “*Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit*”.

-Në 6 raste, në procedurat e negocimit pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, nga autoriteti kontraktor nuk është argumentuar dhe dokumentuar arsyeja e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negocim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 36, pika 4, e cila përcakton se: “*Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë*”.

-Në 2 raste, në procedurat e negocimit pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, shkaqet e pavarura janë të paargumentuara dhe institucioni nuk ndodhet në kushtet e nevojës ekstreme për ngjarje të paparashikuara në kundërshtim me nenin 33 të LPP, pika c ku rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor.”

-Në 3 raste, në procedurat e marrjes me qira të kaldajave, nga Njësia e Prokurimit në përgatitjen e DT nuk është vepruar në përputhje me VKM nr. 914, 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 11.

-Në 1 rast, për procedurën e mbetjeve spitalore prill 2017, anëtarët e komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesave nuk kanë kualifikimet e nevojshme për shqyrtimin e një ankesë referuar VKM nr. 914 “*Për prokurimin publik*” neni 78.

-Në 1 rast, për procedurën e mbetjeve spitalore prill 2017, s’kualifikimi i operatorit ekonomik nga KVO e autoritetit kontraktor është kryer për kritere të pa qenë në dokumentet standarde të tenderit, veprime në kundërshtim me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.



- Në të 16 procedurat e prokurimit të audituar sa mësipër cituar, nuk ka raporte mbi monitorimin e zbatimit të kontratës sipas specifikimeve teknike, sasitë, shërbimet e kryera etj., në kundërshtim me nenet 1, 15 e 17 të kontratës, së lidhur në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX, neni 77, ku gjithashtu në përfundim të kontratës autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX neni 77, pika 1.

Shkeljet sa mësipër referuar llojit të mangësive dhe interpretimit jo të drejtë të akteve ligjore, kanë rezultuar dhe në auditime të mëparshme (*Më hollësisht trajtuar në faqet 32- 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i lartë

#### **Rekomandmi 9**

*-Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të hartuar kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike;*

*-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente;*

*-Nga Drejtori i Spitalit t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt;*

*-Nga titullari i autoritetit kontraktor dhe Nëndrejtori Ekonomik të bëhet ndarje e detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe të zyrtarëve të përfshirë në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesit në mënyrë që të dalin përgjegjësitë individuale gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit si dhe të emërohen punonjës me arsim të lartë në zbatim të legjislacionit në fuqi.*

*-Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në çdo rast të dokumentojë dhe argumentojë gjatë realizimit të procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje, mënyrën dhe arsyen e përzgjedhjes të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurë.*

*-Të bëhet në mënyrë të vazhdueshme monitorimi i zbatimit të kontratave dhe të hartohen raportet e zbatimit të kontratave me konkluzionet e tyre, konform kërkesave të legjislacionit të prokurimeve.*

**Vazhdimisht**

#### **Gjetje nga auditimi 10**

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se:

- Për vitin 2016 janë realizuar 253 procedura prokurimi, nga të cilat 144 me procedurë me blerje me vlerë të vogël, si dhe për vitin 2017 janë realizuar 191 procedura në total, nga të cilat 83 me blerje me vlerë të vogël. Për vitin 2016 janë realizuar 320,000,000 lekë me TVSH, si dhe për vitin 2017 janë realizuar 312,493,098 lekë me TVSH. Nga 37 procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës të zhvilluara nga AK për vitin 2016 dhe 2017 janë audituar rreth 31% e tyre. Duke u bazuar në analizën e riskut dhe tek vlera e kontratave, janë audituar rreth 40% e fondeve të SUSHN, si dhe 15 procedura prokurimi, duke përfshirë edhe zbatimin e kontratave si dhe 30 procedura prokurimi, duke përfshirë edhe zbatimin e kontratave.

-Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83/2, ndonëse nga AK janë bërë kërkesa të vazhdueshme drejtuar APP, por si institucion varësie nga Ministria e Shëndetësisë, nuk ka akses për trajnim.

- Në të gjitha rastet e audituara, nuk konstatohet të jetë argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Në të gjitha rastet e audituara, nga njësia e prokurimit janë vendosur kritere në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20 dhe neni 46.

- Në 6 raste, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 3.

- Në 5 raste, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1.

- Në 6 raste, në kundërshtim me nenin 68 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në kushtet kur në raportin përmbledhës mungojnë të dhëna kryesore si, referenca e procedurës së prokurimit dhe përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, titullari i AK, bazuar në dispozitën e sipërcituar nënligjore, në kushtet e mungesës së elementëve thelbësorë të sipërpërmendur, nuk duhej të kishte bërë miratimin e këtij raporti përmbledhës.

- Në të gjitha rastet, procedurat e përfunduara nuk ishin të inventarizuara dhe të arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 161-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i Riskut:** I lartë

### **Rekomandimi 10**

*Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve duke marrë masa për trajnimin e stafit mbi prokurimet publike, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt, me qëllim rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj. Gjithashtu, duhet të merren masat përkatëse, lidhur me zbatimin e kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues, sipas kushteve të rënë dakord midis palëve.*

**Vazhdimisht**

### **7. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile.**

#### **Gjetje nga auditimi 11**

Nga auditimi në SUSHN për procesin e dhënies me qira të ambienteve për vendosjen e antenës të A. sha ka rezultuar se, në kundërshtim me ligjin nr.10 469, datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jo jonizuese”, neni 4c, operatori ekonomik A. sha, nuk ka dorëzuar Akt Miratimin nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jo jonizuese, dokument i nevojshëm për kontratën e lidhur me SUSHN (*Më hollësisht trajtuar në faqet 198- 208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i mesëm

#### **Rekomandim 11**

*Nga SUSHN të merren masa dhe ti kërkohet operatorit ekonomik A. sha të paraqesë Akt Miratimin nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi referuar ligjit në fuqi për rastin e mbivendosjes në një stacion tjetër. Në mungesë të marrjes së këtij dokumenti nga SUSHN të merren masa për ndërprerjen e kontratës dhe mos ripërtëritje të saj me këtë operator ekonomik.*

***Menjëherë***

### **Gjetje nga auditimi 12**

Nga ana SUSHN në zbatimin të kontratës nr. 566, datë 31.07.2015 së shërbimit me ushqim për pacientët dhe stafin mjekësor, nuk është kryer asnjë kontroll për të verifikuar specifikimet teknike dhe nuk janë kryer analiza për kontrollin e cilësisë së ushqimit, në kundërshtim me nenin 33 të saj dhe vendimin e KM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu nga komisioni i marrjes në dorëzim nuk janë përgatitur raporte për pasqyrimin e cilësisë së shërbimit bazuar në specifikimet teknike të kontratës (*Më hollësisht trajtuar në faqen 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i mesëm

### ***Rekomandim 12***

*Komisionet apo personat e ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të shërbimit me ushqim, të marrin masa për të realizuar kontrole periodike për cilësinë e ushqimit dhe plotësimin specifikimeve teknike të kërkuara si dhe të përgatisin raporte për autoritetin kontraktor për realizimin e kontratës sipas kërkesave të kontraktuara.*

***Menjëherë***

### **Gjetje nga auditimi 13**

Nga auditimi i kontratës nr. 63/13 datë 23.08.2017 me objekt “ Lot 1- Blerje materiale të buta dhe veshmbathje”, ka rezultuar se nuk janë përgatitur raporte për pasqyrimin e cilësisë dhe kolaudit të mallit, bazuar në specifikimet teknike, në kundërshtim me nenin 5 pika 1 të saj dhe vendimin e KM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me përfundimin e kontratës. Gjithashtu në kundërshtim të nenit 4, pika 2 të kontratës “Kushtet e Pagesës”, nuk janë respektuar afatet e kryerjes së pagesës për shërbimin (*Më hollësisht trajtuar në faqen 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i mesëm

### ***Rekomandim 13***

*Komisionet apo personat e ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave në përfundim të tyre të përgatisin raporte për pasqyrimin e cilësisë dhe kolaudit të mallit bazuar në specifikimet teknike të kontratave. Gjithashtu nga zyra e financës, referuar limiteve mujore të fondeve të miratuara, të ndiqen politika të kujdesshme në respektimin e afateve të kryerjes së pagesave sipas përcaktimeve në kontratë.*

***Menjëherë***

### **Gjetje nga auditimi 14**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës Nr. 697/13 datë 31.03.2017 me objekt “ Shërbim dhe mirëmbajtje e aparaturave mjekësore (Mirëmbajtje CT Skaner dhe Mirëmbajtje Angiografi)”, ka rezultuar se nga AK (punonjësi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës) nuk ka marrë masa për respektimin e afateve të kryerjes së kontrollit periodik funksional të pajisjeve dhe aksesoreve përbërës nga operatori i kontraktuar (*Më hollësisht trajtuar në faqen 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i mesëm

### ***Rekomandim 14***

*Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që zbatimi i kontratave të ndiqet me rigorozitet sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në to dhe të kërkojë zbatimin e afateve kohore të*

*kontrollit periodik funksional të pajisjeve dhe aksesorëve përbërës, duke respektuar nenin 12 të kontratës.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 15**

Nga auditimi ka rezultuar se për të dy vitet 2016 dhe 2017, në kundërshtim me neni 6 të kontratave të shërbimit me roje private, nuk është zbatuar detyrimi për vendosjen e sinjalit të alarmit për thyerjet e brendshme në farmacinë e spitalit. Ky konstatim është dhe për kontratat e shërbimit të cilat funksionojnë në vitin 2018 (*Më hollësisht trajtuar në faqen 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i mesëm

#### **Rekomandim 15**

*Nga Autoriteti Kontraktor, në bashkëpunim me operatorin ekonomik aktual “L. s”, të marrin masa për të zbatuar detyrimin e tij kontraktual, për të vendosur sinjal alarmi për thyerjet e brendshme në farmacitë e spitalit.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 16**

Nga auditimi i kontratave për shërbimin me roje private, për vitet 2016 dhe 2017 ka rezultuar se në kundërshtim të ligjit 75/2014 “Për Shërbimin privat të sigurisë fizike, nuk janë përfshirë si dokumentacion bashkëlidhur kontratës, të dhënat e përcaktuara në ligjin si: nënkategoria e licencës; drejtuesi teknik; rregulla për regjimin e hyrjes dhe daljes, të ndriçimit, të rrethimit, të mjeteve vëzhguese e sinjalizuese. Nga ana e AK është hartuar një rregullore e brendshme me nr. 595/54 datë 8.10.2017 ku përfshihen një pjesë e këtyre kërkesave ligjore, por jo të gjitha (*Më hollësisht trajtuar në faqet 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i ulët

#### **Rekomandim 16**

*Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa dhe të përfshihen të gjitha të dhënat e përcaktuara në ligjin në fuqi në dokumentacionin e dosjes së kontratave në vijim për shërbimin privat të sigurisë fizike.*

**Menjëherë**

### **8. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël.**

#### **Gjetje nga auditimi 17**

a-Nga auditimi në SUSHN rezultoi se dokumentacioni i shpenzimeve me bankë e arkë si dhe i gjithë sistemi i kontabilizimit është mbajtur në mënyrë manuale, ku përveç të tjerave vështirëson nxjerrjen e raporteve për efekt krahasueshmerie, për rrjedhje dhe auditimin e shumave përmbledhëse të shpenzimeve dhe ngarkimin e tyre në kontabilitet. Mbajtja në mënyrë manuale shton risqet e gabimeve njerëzore dhe shton vështirësitë në gjetjen e tyre.

b-Gjithashtu gjatë auditimit të bankës për vitet 2016 dhe 2017 në lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, rezultoi se urdhër shpenzimet, pasqyrat financiare konfirmoheshin nga NA dhe NZ, ku nëpunësi zbatues është caktuar shefi i financës dhe ku referuar strukturës organizative të miratuar është nën vartësinë e N/Drejtorit Ekonomik, veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, neni 12 pika 1.

c-Theksojmë gjithashtu se nga Titullari i institucionit, NZ është caktuar njëkohësisht dhe kryetar i komisionit për blerje me vlera të vogla si dhe anëtar i KVO në procedura tenderimi. Emërimi në këto funksione të NZ aktual pra të emëruar dhe funksional në këto dy vite bie në kundërshtim me nenin 22/3b të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010. Raste të tilla ku shkelet ky parim ka pasur edhe kur faturat e operatoreve firmosen nga magazinieri kur ky ka pranuar mallin në magazinë apo farmacisti kur ky ka pritur dhe futur mallin në farmaci (*Më hollësisht trajtuar në faqet 208-228 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i lartë

### **Rekomandimi 17**

*-Nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i SUSHN të organizohet mbajtja e kontabilitetit me një nga programet e integruara, të përshtatshme për institucionet buxhetore, gjë që e bën më të përshtatshme për kohën dhe cilësinë, mbajtjen e kontabilitetit dhe nxjerrjen e informacionit kontabël të institucionit.*

*-Nga Nëpunësi Autorizues i SUSHN të emërohet apo të delegohen funksionet e Nëpunësit Zbatues konform kërkesave ligjore dhe referuar kompetencave të lejuara nga ligji.*

*-Të shmangen emërimet e nëpunësit zbatues në komisione të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet në ligjin për MFK dhe njëkohësisht dhe me konfliktin e interesit. Kjo procedurë të ndiqet dhe me të emëruarit e tjerë nëpër komisione.*

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 18**

a-Nga auditimi ka rezultuar se si për vitin 2016 dhe 2017 në Regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik blerjet me procedurë prokurimi me vlerë të vogël nuk kanë detajimin sipas blerjeve ashtu siç janë paraqitur në regjistrin e realizimit publik. Gjithashtu rezultoi se nga Autoriteti Kontraktor nuk janë ndryshuar regjistrat për fondet shtesë të çelura gjatë vitit 2016 dhe 2017, veprim që bie në kundërshtim me kreun IV, blerja me vlera te vogla pika 2 të ligjit PP dhe udhëzimit nr. 3 datë 27.01.2015, "Për blerjet e vogla", pika 4.

b-Gjithashtu referuar shumës së prokuruar si gjatë vitit 2016 dhe vitit 2017 ka rezultuar se, nga AK janë tejkualuar fondet e çelura duke prokuruar më shumë nga fondet në dispozicion, si dhe fondet e planifikuara për prokurim,veprim që bie në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit neni 44,50.

c- Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të likuidimeve nëpërmjet bankës për vitin 2016 dhe vitin 2017 ka rezultuar se në 23 raste të trajtuara në raport auditimi (por likuidimi i faturave me vonesë ishte fenomen i identifikuar gjatë gjithë vitit) është tejkualuar afati 30 ditë i likuidimit të faturës së paraqitur nga operatorët për mallra e shërbime të kontraktuara, veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 52.

d- Nga të dhënat e marra nga dokumentacioni i bankës dhe dosjet e prokurimit me vlerë të vogël rezulton se gjatë vitit 2016 dhe 2017, janë realizuar procedura me blerje të vogël, ku fondi limit argumentohet me oferta të cila nuk kanë konfirmimin e datës së lëshuar dhe shpesh herë i pa argumentuar, veprime bien në kundërshtim me VKM nr. 914 "Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik" neni 5 pika 2.

e-Po kështu ne shumë raste të procedurave me blerjeje me vlera të vogla nuk kanë filluar me kërkesë të sektorëve përkatës të cilat kanë nevojë për mallra, shërbime dhe punë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 date 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogël" pika 4, si dhe Urdhrin nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë të vogël.

f-Gjatë vitit 2016 dhe vitit 2017, për të njëjtën grup artikujsh apo natyrë të njëjtë malli, shërbimi apo pune si (blerje banak inoksi, blerje tonerë, servil ambulance, blerje bojëra plastike hidromat, blerje pajisje për riparim lavatriçeje, blerje shtypshkrime, shërbim mirëmbajtje ashensori, blerje material kancelarie, blerje materiale hidraulike, blerje materiale pastrimi) janë realizuar 2 dhe më shumë procedura të ndara veçmas duke bërë kështu që vlera totale e fondit limit te copëtohet në shumë pjesë, me qëllim shmangien e përdorimit te procedurave elektronike dhe përdorimin e procedurës se prokurimit nen vlerën e 100 mijë leke apo realizimin e procedurës referuar fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 914 "Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik" (Më hollësisht trajtuar në faqet 208-228 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Niveli i riskut:** i lartë

### **Rekomandimi 18**

*-Mbështetur në faktin se mangësitë e cituara mësipër në shkelje të legjislacionit janë mangësi që janë të rezultuara në autoritet në disa vite dhe auditime, rekomandojmë AK thellimin në njohjen me legjislacionin përkatës si në procesin e prokurimit publik (me të gjitha elementët e tij që nga hartimi i regjistrave dhe procedurat e inicimit të procesit të prokurimit) ashtu dhe në planifikimin, hartimin dhe zbatimin e buxhetit konform të gjitha kërkesave dhe hapësirave ligjore të parashikuara në aktet ligjore në fuqi dhe të cituara mësipër.*

**Në vazhdimësi**

### **Gjetje nga auditimi 19**

Gjatë auditimit me zgjedhje të likuidimeve nëpërmjet bankës rezultoi se gjatë vitit 2016 në vlerën 3,108,983 lekë dhe gjatë vitit 2017 në vlerën 838,383 lekë janë pranuar nga komisioni i pritjes së mallit dhe likuiduar barna, kite dhe reagente të cilat e kanë pasur afatin e skadencës më të vogël se 1 vit, veprim që bie në kundërshtim me DST të paraqitura në procedurën e prokurimit si dhe në dokumentet standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe APP (*Më hollësisht trajtuar në faqet 208-228 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i lartë

### **Rekomandimi 19**

*Nga komisionet e marrjes në dorëzim të barnave, kite dhe reagente të zbatohen me përpikëri marrja e tyre konform të gjithë kërkesave dhe specifikimeve teknike të kontraktuara. Nga AK duhet që, konform legjislacionit në fuqi, politikat e nevojave për mallra emergjente të jenë pjesë e procedurave të menaxhimit të fondeve dhe procedurave të prokurimit, të ndara nga praktikat e plotësimit të kërkesave të operatorëve konform përcaktimeve kontraktuale, duke monitoruar dhe shmangur çdo rast të pranimit të barnave, kiteve dhe reagjentëve nën afatet e kontraktuara të skadencës dhe argumentuar ato si pasojë e nevojës emergjente.*

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 20**

Nga auditimi ka rezultuar se me ush nr. 824, datë 19.12.2016 janë kryer pagesa për rimbursim shpenzimesh jashtë vendit, në zbatim të urdhrit të titullarit nr. 862, datë 13.12.2016 në shumën 122,400 lekë për shpenzime hoteli për dy punonjës mjek (z. R..K dhe z.L. L). Referuar praktikës së vendosur bashkëlidhur ka rezultuar se nuk janë zbatuar kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.870, date 14.02.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë shtetit” dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.22, datë 10.07.2013 në zbatim të tij, pasi nuk ka nxjerrje të urdhrit para kryerjes së udhëtimit duke argumentuar dhe domosdoshmërinë e shërbimit jashtë vendit. Gjithashtu dokumentacioni i paraqitur për shpenzime hoteli është një dokument që verifikon arkëtimin e shumës, por pa konfirmime zyrtare të personit arkëtues (jo faturë hoteli). Referuar situacioneve të shpenzimeve ka rezultuar se për vitin 2016 janë shpenzuar 482,864 lekë për udhëtime jashtë vendit dhe për vitin 2017 shuma 150,135 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqet 208 -228 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i mesëm

### **Rekomandimi 20**

*Nga struktura e Auditimit të Brendshëm të SUSHN të programohet auditim në lidhje me përdorimin dhe dokumentimin ligjor të fondeve buxhetore për vitin 2016 dhe 2017, të përdorura për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë shtetit, në shumën 632,999 lekë.*

**Menjëherë**

### ***Mbi përdorimin e karburantit.***

#### **Gjetje nga auditimi 21**

a-Nga auditimi mbi përdorimin e karburantit konform rregullave të miratuara dhe normativave të konsumit për mjet, gjatë vitit 2016 dhe 2017 u rezultuan mangësi në plotësimin e fletë udhëtimeve në drejtim të konfirmimit të tyre, të distancave të ndryshme kilometrike të llogaritura referuar të njëjtit destinacion si dhe mungesa e kontrollit të krahasimit të karburantit të tërhequr me karburantin e konsumuar referuar kilometrave të përshkruara dhe normativave të konsumit për çdo mjet.

b- Gjithashtu nga auditimi rezultoi se jo të gjitha mjetet ambulanca kishin kontrollin teknik periodik konform rregullave të përcaktuara në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, duke theksuar se automjeteve ambulanca në shërbim të paraspitalorit i mungonte kontrolli teknik prej disa vitesh, duke u kthyer kështu në rrezik për përdoruesit (shofer staf mjekësor dhe pacient) dhe popullatën në rrugë (*Më hollësisht trajtuar në faqet 208-228 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i lartë

#### **Rekomandimi 21**

*-Nga sektori teknik i SUSHN të ndiqet rregullshmëria e plotësimin të fletë udhëtimeve në drejtim të mbajtjes, konfirmimit, vendosjes reale të distancave kilometrike. Për çdo periudhë mujore të bëhet rakordimi midis karburantit të tërhequr dhe atij të konsumuar në mënyrë që mjetet të tërheqin karburant progresivisht konform nevojave, pa krijuar diferencë gjendje.*

*-Nga Sektori Teknik në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të planifikohen nevojat me fondet përkatëse për kontrollet teknike të mjeteve ambulanca dhe çdo shpenzim për to, në mënyrë që ato të lëvizin konform kërkesave të kodit rrugor dhe gatishmërisë teknike për kryerjen e funksioneve në kushte normale dhe ligjore.*

***Menjëherë***

### **10. Auditim mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimin e brendshëm.**

#### **Gjetje nga auditimi 22**

-Nga auditimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, sistemit të kontrollit të brendshëm dhe funksionimit të tij, u konstatua se në përgjithësi elementët e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen nga njësia dhe janë të implementuara në shkallë shumë të ulët. Ky fakt provohet nga niveli i ulët i përputhshmërisë me kërkesat e manualit për menaxhimin financiar për kontrollin, ku njësia nuk ka përpiluar pyetësorin e vetëvlerësimit dhe deklaratën e cilësisë së kontrolleve si bazë për vlerësimin e secilit komponent në kundërshtim me Ligjin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nr. 10296 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V, Shtojca 2.

-Për përbërësit e secilit komponent, nuk ka një rregullore të përditësuar për funksionimin administrativ në përshtatje të strukturës së ndryshuar, nuk janë përmbytur plotësisht detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrisë të Risqeve, objektivave të vendosura, strategjive të riskut, nuk ka procedura të mirëfillta monitorimi, si dhe ka angazhime në numër të vogël të misioneve të auditimit të brendshëm si pasojë e krijimit të vonuar të kësaj strukture në maj të vitit 2017, veprime të cilat vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive në kundërshtim me nenet 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c,16 dhe 21 të ligjit nr. 10296 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"

-Në rolin e nëpunësit zbatues të institucionit, është vendosur përgjegjësi i sektorit të financës si pozicion pune në kundërshtim me Ligjin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit Nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 18, ku nëpunës

zbatues i njësisë publike është nëpunësi i nivelit më të lartë menaxherial në strukturën me përgjegjësi për çështjet ekonomike (*Më hollësisht trajtuar në faqet 230-235 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Niveli i riskut:** i lartë

### **Rekomandimi 22**

*-Nga Drejtori i Spitalit të merren masa për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm e menaxhimit financiar, duke evidentuar problematikat dhe rekomandimet konstatuara si dhe të merren masa për ngritjen e kapaciteteve në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.*

*-Nga ana e institucionit të kërkohet kryerja e trajnimeve në Ministrinë e Financave për kuptimin dhe implementimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar. Gjithashtu të merren masa për hartimin e një rregullore të re për përcaktimin e saktë të detyrave sipas strukturës së miratuar dhe përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve të punës për çështje të raportimit, delegimit dhe përgjegjësi, si dhe të regjistrit të riskut e strategjisë së njësisë.*

*-Nga ana e auditimit të brendshëm të kryhen angazhime të auditimit në përputhje me manualin e auditimit të brendshëm, duke vlerësuar paraprakisht riskun e brendshëm dhe të ofrohet siguri në auditimin e zonave më me risk sipas këtij vlerësimi.*

*-Të merren masat përkatëse që për plotësimin e strukturës së Njësisë së auditit të brendshëm, ku në përbërje të njësisë të jetë edhe një ekspert i fushës, sipas nevojave të sektorit që auditohet, referuar natyrës specifike të spitalit.*

*-Nga Drejtori i Spitalit të merren masa për plotësimin e të gjitha kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar në drejtim të përcaktimit të nëpunësit zbatues, procedurave anti korrupsion, delegimit të kompetencave, hartimit të regjistrit të riskut dhe koordinatorit për menaxhimin e tij, etj.*

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 23**

Nga auditimi i tre procedurave të prokurimit “**Marrje e dy kaldajave me qira për ngrohje me lëndë djegëse-Pellet**” për periudhën objekt auditimi, rezultoi se kaldajat për disa vite shërbimi nuk janë montuar dhe c’montuar sipas parashikimeve në kontratë, për rrjedhojë punimet e vendosura për këto lëvizje të tyre, janë parashikuar fiktivisht, pavarësisht se nuk janë të vlerësuara me vlerë, në kontratat e qerasë.

Gjithashtu është konstatuar se nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë planifikohen çdo vit shuma të konsiderueshme fondesh buxhetore për shpenzimet e marrjes me qira të dy kaldajave duke harxhuar për vitet 2012-2017 në total 57,161,058 lekë me tvsh (periudhë kur ky shpenzim identifikohet i veçantë si marrje me qira).

Gjatë periudhës së auditimit nuk është konstatuar që nga SUSHN të studiohet mundësia e blerjes së kaldajave, në një kohë që ngrohja e ambienteve spitalore është një proces i vazhdueshëm dhe i domosdoshëm në shërbimin spitalor dhe që e bën blerjen e tyre, të vlefshme dhe më efektive se sa marrja me qira (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Rekomandimi 23**

*Nga Drejtoria e Spitalit për efekt të përdorimit më me efektivitet të fondeve për këtë shërbim dhe shmangien e fiktivitetit të procesit të marrjes me qira, të studiohet tregu dhe të analizohet leverdishmëria e blerjes së pajisjeve kaldaja, duke i propozuar blerjen e tyre, referuar analizës së efektivitetit të rezultuar, MSHMS me qëllim miratimin e fondeve të domosdoshme buxhetore për këtë investim.*

**Menjëherë**



## **Gjetje nga auditimi 24**

Nga auditim për dhënien me qera te ambienteve ne pronësi te SUSHN u konstatua se janë dhënë me qera shoqërise “ D. E” zyra, tualet dhe ambient i jashtëm. Nga grupi i auditimit rezultoi se përlllogaritja e vlerës së qirasë mujore nuk përputhet me sipërfaqen e shfrytëzuar nga shoqëria dhe si rrjedhojë e këtij veprimi janë shkaktuar te ardhura te munguara për buxhetin e SUSHN, ku personat përgjegjës janë E. F në cilësinë e ish titullarit të AK, shoqëria “D.E” në cilësinë e kontraktorit, si dhe Ark A. J, Ing. Gj. DH në cilësinë e personave përgjegjës specialist të fushës, të cilët kanë bërë përlllogaritjet dhe matjet për sipërfaqen e dhënë më qira. Gjithashtu u konstatua se kontrata e lidhur me shoqërinë D. E nuk parashikon penalitete ne raste te mos zbatimit te kontratës nga palët.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 96-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

## **Rekomandimi 24**

*Nga Drejtoria e Spitalit, për efekt të maksimizimit të të ardhurave, si dhe të përdorimit më me efektivitet të aseteve, të merren masat përkatëse që dhënia me qira e tyre të bëhet konform dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu, kushtet e kontratës së nënshkruar midis palëve, në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, duhet të përfshijnë edhe penalitetet.*

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **Gjetje nga auditimi 1**

Nga auditimi i zbatimit të tre procedurave të prokurimit me objekt: **“Blerje lënde djegëse për ngrohje (pellet)”** të zhvilluara në vitin 2016 dhe 2017 me fitues operatorin ekonomik “L. Shpk” për vitin 2016 dhe “B. Shpk” për vitin 2017, nga llogaritjet e bëra nga grupi i auditimit, referuar konsumit të kaldajave, testuar gjatë auditimit si rezultat i mungesës së treguesve të dy kaldajave (nuk u paraqit manual përdorimi dhe norma konsumi dhe kaldajat nuk dispononin si pjesë të tyre patentën teknike), duke u nisur dhe nga fakti i marrjes në dorëzim të “lëndës djegëse pelet” jashtë kushteve të specifikuara në kontratën e lidhur, si nga cilësia e peletit (përbërja pra 85 % dru ahu dhe 15 % dru bredhi) ashtu dhe nga ambalazhimi (jo me thasë të mbyllur 15 kg, gjë që e vë në dyshim sasinë e dorëzuar të peletit nga operatorët përkatës, në një kohë që pothuajse në të gjitha aktet e dorëzimit të mallit nuk kishte dokument të peshimit të peletit të dorëzuar të paraqitur nga operatori apo të peshuar nga SUSHN), është konstatuar, se sasia e peletit që duhet të ishte e konsumuar është më e ulët se sa sasia e faturuar dhe e likuiduar.

-Gjithashtu testimet e kryera për normat e konsumit dhe llogaritjet e bëra në lidhje me konsumin e peletit për periudhat kohore të miratuara nga titullari për funksionimin e kaldajave, u rezultua se të dy kaldajat e instaluara dhe marra me qira nuk konsumojnë sasinë e raportuar nga grupi i verifikimit dhe marrjes në dorëzim, duke e rritur artificialisht si konsumin faktik, dhe nevojën për lëndë djegëse pelet, me rreth 24%.

Duke u nisur nga fakti që operatori ekonomik nuk ka sjellë mallin konform specifikimeve teknike të kontraktuara kjo e vërtetuar me dokumentacionin e paraqitur nga operatori, duke u bazuar dhe në konsumin e testuar nga grupi i auditimit nga kaldajat për periudhën e vitit 2016 dhe 2017, ka rezultuar se vlera e përfituar padrejtësisht nga operatorët ekonomikë për periudhën objekt auditimi është **4,928,595 lekë me tvsh** e cila përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **Rekomandimi 1**

*-Nga Drejtoria e Spitalit, Drejtoria e Financës të merren masa për kontabilizimin e dëmit të konstatuar dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 2,419,022 lekë me tvsh,***

nga operatori ekonomik "L" shpk, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pelet)" për vitin 2016.

-Nga Drejtorja e Spitalit, Drejtorja e Financës të merren masa për kontabilizimin e dëmit të konstatuar dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 2,509,572 lekë me tvsh**, nga operatori ekonomik "B" shpk, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pelet)" për vitin 2017.

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 2**

Nga auditimi i zbatimit të 9 procedurave të prokurimit me objekt "**Evadimi i Mbetjeve të rrezikshme Spitalore**" për periudhën objekt auditimi me fitues operatorin ekonomik "M-T" shpk, është konstatuar se pesha e mbetjeve spitalore referuar dokumentacionit të analizuar nga grupi i auditimit, të rezultuara për dy vitet 2016-2017 është më e ulët se pesha e faturuar dhe e likuiduar. Vlera e përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik është **3,451,264 lekë me tvsh** (përkatesisht 1,576,028 leke për vitin 2016 dhe 1,875,236 lekë për vitin 2017) përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Rekomandim2**

-Nga Drejtorja e Spitalit, Drejtorja e Financës të merren masa për kontabilizimin e dëmit të konstatuar dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 3,451,264 lekë me tvsh**, nga operatori ekonomik "M-T" shpk, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratave me objekt "**Evadimi i Mbetjeve të rrezikshme Spitalore**" për vitin 2016-2017.

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 3**

Nga auditimi i procedurës së zbatimit të kontratës me objekt: "Blerje medikamente për vitin, 2016", me fond limit 28,489,900 lekë pa TVSH, datë zhvillimi 03.02.2016, sipas kontratës së nënshkruar Nr. 159/8 datë 03.02.2016, me kontraktorin "M. S" shpk, me ofertën 28,397,877 lekë pa tvsh, me një ulje të papërfillshme nga fondi limit prej **0.32%**, është konstatuar se për një pjese të mallrave (medikamenteve/barnave) që shoqëria duhet të furnizonte SUSHN sipas kushteve të kontratës nuk ka mundur që të sigurojë dhe kjo për arsye të mungesës së këtij medikamenti. Duke qene para këtij fakti AK për mos përmbushje të detyrimeve kontraktore duhet që të kishte mbajtur sigurimin e kontratës në vlerën **2,839,787 lekë** dhe mos ta çlironte atë (sigurimin e vlerës së kontratës).

-Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për **arkëtimin i vlerës prej 2,839,787 lekë nga personat përgjegjës**, që përfaqëson vlerën e sigurimit të kontratës e cila duhej të mbahej nga kontraktori "M. S" Sh.p.k., për mospërmbushje të të gjithë detyrimeve kontraktore.

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 4**

Nga auditimi i zbatimit të kontratave "Për shërbimin e ruajtjes me roje private" të lidhura për vitin 2016 dhe 2017 u konstatua se, nga Operatori "L. S" janë përfshirë në situacionin e shpenzimeve për shërbimin e kontraktuar, zërat e shpenzimeve për armatim, uniformë dhe ndërlikime, duke shkaktuar **dëmin ekonomik në vlerën 457,797 lekë**, veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr. 8770, datë 19.4.2001, "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë

fizike" dhe ligjin nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", ligjin nr.1491, datë 21.06.2001" Për pajisjen e SHRFS-ve me armatim municione dhe mjete speciale" të konfirmuara si fenomen shkeljesh dhe të rekomanduara si interpretim i ligjit nga Agjencia e Prokurimit Publik më datën 20.12.2017, ku këto zëra shpenzimesh janë detyrim i operatorëve ekonomik dhe jo i Autoritetit Kontraktor (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Rekomandim 4**

*-Nga AK të merren masa për të kontabilizuar dhe ndjekur të gjitha procedurat përkatëse të nevojshme administrative e ligjore për t'i kërkuar operatorit ekonomik "L. S" Shpk, shpërblimin e dëmit në vlerën 457,797 Lekë.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 5**

Nga auditimi i procedurës së zbatimit të kontratës me objekt: "Rikonstruksion në S.U. Shfaqet Ndroqi për sistemimet e jashtme, kanalizimet, ndriçimi dhe ashensori në godinën e administratës etj, faza III", sipas kontratës së sipërmarrjes Nr. 724 Prot., datë 30.10.2015, me vlerë kontrate 162,223,281 lekë me TVSH, vlera e dëmit ekonomik është **3,886,003 lekë**, si rezultat i çmimeve të paargumentuara, të pa dokumentuara dhe të tej fryra që ka përcaktuar projektuesi i këtij objekti në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, ku personat përgjegjës janë projektuesi i hartimit të projekt-preventivit të objektit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 96-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Rekomandimi 5**

*Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës prej 3,886,003 lekë**, përkatësisht nga projektuesi i objektit.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 6**

*Nga auditim i ushtruar mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për dokumentimin dhe qarkullimin e medikamente, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 126,382 lekë, si rezultat i marrjes në dorëzim të mallit, në kundërshtim me kushtet e kontratës, si dhe daljes së tij nga magazina e farmacisë, ku aktualisht ky bar rezulton gjendje i skaduar, ku personat përgjegjës janë Znj. B. G, Znj. L. N, Znj. L. K, në cilësinë e punonjësve të farmacisë, si dhe të gjithë personat e tjerë përgjegjës për marrjen e mallit në dorëzim, të cilat kanë qenë të punësuar pranë farmacisë së institucionit në periudhën jo objekt auditimi,. Titullari i AK duhet të bëjë evidentimet përkatëse mbi të gjithë personat e tjerë, të cilat kanë qenë të punësuar në datat respektive të planifikimit dhe marrjes së mallit në dorëzim (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 96-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).*

#### **Rekomandimi 6**

*Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës prej 126,382 lekë**, nga të gjithë personat përgjegjës, të cilat kanë planifikuar dhe kanë marrë mallin në dorëzim, si dhe të gjithë personat të cilët nuk kanë bërë daljen e tij nga magazina, si dhe nuk kanë marrë asnjë masë për evidentimin e këtij bari të skaduar.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 7**

*Nga auditim i ushtruar mbi procedurën "Blerje medikamente për nevojat spitalore ndarë në lote" me afat nga data 30.01.2017 deri më datë 15.04.2017, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën prej (34,953,780 x 4/1000) x 4 ditë vonesa = 511,260 lekë, si dhe në vlerën prej 169,509 lekë, në total 680,769 lekë, për arsye se nuk është aplikuar tarifa ditore për dorëzimin e mallit me vonesë, mbi penalitetet sipas kushteve të kontratës, si dhe është kryer një shpenzim i paligjshëm, në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP, për mosdorëzim të*

mallit sipas kushteve të kontratës, ku personat përgjegjës janë B. G, L.N dhe M. T (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 96-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandimi 7**

Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **680,769 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “I” Sh.p.k.

**Menjëherë**

**Gjetje nga auditimi 8**

Nga auditim i ushtruar mbi zbatimin e kontratës me objekt: “Blerje materiale mjekimi për shërbimin e hermodinamikës” për kontratën nr. 142/5 prot, datë 14.04.2017 dhe 142/4 Prot., datë 14.04.2017, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën prej 783,236 lekë, si dhe në vlerën prej 445,327 lekë, në total **1,228,563 lekë**, pasi nuk është aplikuar tarifa ditore për dorëzimin e mallit me vonesë, mbi penalitetet sipas kushteve të kontratës, ku personat përgjegjës janë Znj. B. G, Znj. M. P, Z. A. M, në cilësinë e personave përgjegjës të marrjes së mallit në dorëzim (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 96-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandimi 8**

Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **1,228,563 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “O. D” Sh.p.k.

**Menjëherë**

**Gjetje nga auditimi 9**

Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e kontratës me objekt: “Blerje medikamente anti-TBC për nevojat spitalore S.U.S.N.”, sipas kontratës Nr. 166/18 Prot., datë 14.08.2017 të lidhur me shoqërinë “F Sh.p.k. është konstatuar dëm ekonomik në vlerën prej **235,647 lekë**, pasi nuk është aplikuar tarifa ditore për dorëzimin e mallit me vonesë, mbi penalitetet sipas kushteve të kontratës, (sqaruar hollësisht në raport), ku personat përgjegjës janë Znj. D. B, Znj. M P, Znj. L.N, në cilësinë e personave përgjegjës të marrjes së mallit në dorëzim (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 96-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandimi 9**

Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **235,647 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “F” Sh.p.k.

**Menjëherë**

**Gjetje nga auditimi 10**

Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e kontratës për procedurën “Blerje oksigjen i lëngët”, sipas kontratës Nr. 12/3 Prot., datë 21.02.2017, të lidhur me shoqërinë “G.” SH.P.K. është konstatuar dëm ekonomik në vlerën prej **840,000 lekë**, pasi nuk është aplikuar tarifa ditore për dorëzimin e mallit me vonesë, mbi penalitetet sipas kushteve të kontratës, (sqaruar hollësisht në raport), ku personat përgjegjës janë z. S. N, z.A.B, z. A V, z. Sh B, z.. P.P, z..B. G në cilësinë e anëtarëve të cilët kanë marrë në dorëzim mallin, si dhe Znj. E.T si personi përgjegjës për hartimin e kushteve evazive të kontratës (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 96-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandimi 10**

Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **840,000 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “G” SH.P.K.

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 11**

Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e kontratës për procedurën me objekt: “Furnizim-Vendosje mobilim spitalor, viti 2016”, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 253,728 lekë, e cila përfaqëson penalitetin e pa mbajtur (4/1000 e 31,716,000 lekë) x 2 ditë konsiston me vlerën **253,728 lekë**, ku personat përgjegjës janë *Përgjegjësi i Sektorit Teknik, Përgjegjësja e Shërbimeve dhe K/Infermierja e Përgjithshme, si dhe shoqëria fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 161-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Rekomandimi 11**

*Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **253,728 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “G” Sh.p.k. vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.*

*Menjëherë*

### **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

#### **Gjetje nga auditimi 1**

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave rezultojnë se:

-Për periudhën 2011-2014, punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna kanë hapur procese gjyqësore ligjore për të cilat janë marrë 4 vendime të formës së prerë ku 3 vendime janë marrë në vitin 2016 dhe 1 vendim është marrë në vitin 2017 me **vlerë efekti negativ financiar 3,414,229 lekë dhe vlerë 907,653 lekë të shpenzimeve përmbarrimore.**

-Nga verifikimi i deklarimeve në sistemin tatimor janë konstatuar vonesa në deklarinë e listë pagesave për të cilat nuk janë respektuar afatet e deklarimit dhe për këto veprime janë aplikuar gjopa në sistem në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Vlera e tyre prej **275,987 lekë përbën efekt negativ financiar** (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandimi 1**

*-Nga Drejtimi i Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe sektori i financës të merren masa për shqyrtimin e efektit negativ financiar në vlerën totale **4,597,869 lekë**, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna dhe raportimeve me vonesë në sistemin tatimor, të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës.*

*-Nga Drejtimi i Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe Sektori Juridik, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimi i detyrimeve të shtuara përmbarrimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për buxhetin e Spitalit.*

*-Nga Drejtimi dhe sektori i Financës të merren masa që të kryhen rakordime të vazhdueshme me Drejtorinë Tatimore për të siguruar menaxhim më të mirë financiar për Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” duke shikuar mundësinë e shlyerjes së gjobave dhe kamatë vonesave më këste, sipas një skeduli të miratuar nga palët.*

*Menjëherë*

#### **Gjetje nga auditimi 2**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “*Evadimi i Mbetjeve të rrezikshme Spitalore*” për periudhën objekt auditimi dhe “*Blerje lënde djegëse për ngrohje (pellet)*” si dhe zbatimin të tyre të zhvilluar në Janar 2016 rezultojnë se:

-Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi, gjatë periudhës objekt auditimi, ka kryer asgjësimin e mbetjeve spitalore pa pasur leje mjedisore dhe lejen e tipit III.1.B për “Asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme përveç inxhinierimit ose landfillimit”. Për ushtrimin e veprimtarisë pa lejen mjedisore përkatëse Spitali ka marrë gjobë në vlerën **500,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar**.

-Në procedurën e prokurimit të mbetjeve spitalore të zhvilluar në Prill 2016, diferenca midis operatorit të parë të shpallur fitues dhe të tërhequr me operatorin e dytë të kualifikuar e lidhur kontratë është më e madhe se 2%. Lidhja e kontratës është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 58, pika 1 dhe 5. Vlera prej **192,947 lekë ta tvsh e cila përbën vlerën e ofertës mbi masën 2 % të fondit limit, përbën efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit**.

-Në procedurat e prokurimit të mbetjeve spitalore të zhvilluar në Prill 2017 dhe Korrik 2017, është kryer rritje e pajustificuar e fondit limit si rezultat i rritjes së sasisë së mbetjes Spitalore për tu evaduar, të pa argumentuar, përkatësisht në shumat **497,040 lekë pa tvsh dhe 551,760 lekë pa tvsh** vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar** për Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe buxhetin e shtetit.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit “**Blerje lënde djegëse për ngrohje (pellet)**” në janar 2016, është konstatuar rritje fiktive e fondit limit në shumën **1,331,424 lekë pa tvsh** e si rezultat i rritjes së sasisë së pelletit të nevojshme për tu konsumuar, por e pa argumentuar, cila përbën **efekt negativ financiar** në kundërshtim me VKM nr. 912 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandimi 2**

-Titullari i autoritetit kontraktor të shqyrtojë vlerën **2,521,411 lekë pa tvsh**, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 3**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit “Për shërbimin e ruajtjes me roje private” për vitin 2016 dhe 2017 u konstatua se në llogaritjen e fondit limit, nga Autoriteti Kontraktor, janë përfshirë zërat e shpenzimeve për armatim, uniformë dhe ndërlidhje, veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr. 8770, datë 19.4.2001, "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike" dhe ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, ligjin nr.1491, datë 21.06.2001" Për pajisjen e SHRFS-ve me armatim municione dhe mjete speciale” të konfirmuara si fenomen shkeljesh dhe lënë rekomandime në interpretim të ligjit nga Agjencia e Prokurimit Publik më datën 20.12.2017. Këto zëra shpenzimesh janë detyrim i operatorëve ekonomik dhe AK me përfshirjen e tyre në llogaritjen e fondit limit ka shkaktuar efektin financiar në vlerën **445,815 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandimi 3**

Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën **445,815 lekë** dhe eliminimin e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 4**

Nga auditimi ka rezultuar se në zbatim të urdhrimit të prokurimit 157, datë 18.05.2016 komisioni i prokurimit i BVV ka kryer procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e bojërave për lysterjen e ambienteve me fond limit 500,000 lekë. Praktika e ndjekur për këtë

procedurë duke s'kualifikuar të 20 ofertuesit nga 21 të paraqitur në sistem për faktin se nuk kishin sjellë mostrat para kryerjes së procedurës duke përcaktuar fituese operatorin me vlerën më të madhe në shumën 499,500 lekë në një kohë që vlera më e vogël e paraqitur ishte 299,500 lekë, *bie në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr.3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" neni 5*, duke shkaktuar një efekt financiar **ne shumën 226,200 lekë me TVSH**, gjithashtu në praktikë nuk argumentohet dhe fondi limit i vendosur (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 189-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Rekomandimi 4**

*Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 226,200 lekë dhe eliminimin e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 5**

Nga auditimi ka rezultuar se me ush nr. 427, 14.06.2016 likuiduar firma P. S për deratizim të ambienteve të SUSHN në shumën 447,600 blerje e vogël në zbatim të UP nr.134 , datë 21.04.2016. Në këtë praktikë të blerjeve me vlerë të vogël elektronike, ka fituar firma Pastrime Silvio e cila ishte e renditur e 12 përsa i përket ofertës ekonomike e cila varion nga 199,000 lekë (M-T) e deri në 399,000 lekë (A Sh P L).Komisioni në procesverbalin nr. 2 datë 27.04.2016 thekson se ka s'kualifikuar firmat pasi nuk kanë paraqitur mostrat e dizifektantit para hapjes së tenderit sipas përcaktimit në ftesën për ofertë.

Në ftesën e ofertës nuk përcaktohet data e sjelljes së mostrës por vetëm ora, në një kohë që për dokumentacionin e kërkuar i lihet kohë 24 orë mbas shpalljes së operatorit fitues. Sa më sipër mënyra e përcaktimit të operatorit fitues nga komisioni bie në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr.3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" neni 5 ku citohet ndër të tjera: " ...Në varësi të objektit të prokurimit, autoriteti kontraktor mund të përcaktojë në ftesën për ofertë dokumentacionin që vlerëson të nevojshëm për tu paraqitur nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues. Kjo ftesë për ofertë do të publikohet në sistemin e prokurimit elektronik për çdo të interesuar". **Sa mësipër është shkaktuar efekti financiar prej 199,000 lekë ( 398,000 lekë oferta fituese 199,000 lekë oferta më e ulët)**. Gjithashtu në praktikë nuk ndodhet procesverbal dhe raport i kryerjes së shërbimit veprim që bie në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2 datë 06. 02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar pika 152 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 189-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Rekomandimi 5**

*Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 199,000 lekë dhe eliminimin e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 6**

Nga auditimi ka rezultuar se me urdhër prokurimi nr.283/1, datë 28.09.2016 "Për prokurimin me vlerë të vogël" hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me "full risk" për mirëmbajtje të ashensorëve për tre muaj (kontrata 40/1 dt 30.09.2016 paguar shërbimi për muajin tetor nëntor 2016 me ush. 794, dt 2.12.2016 dhe nr.795, datë 2.12.2016 (2 ashensorë të mëdhenj nga 700 kg, 2 të vegjël me nga 370 kg dhe 4 mini ashensorë të sallave). Nuk ka argumentim të nevojës për këtë shërbim dhe të përcaktimit të fondit limit prej 200,000 lekë. Gjithashtu nga ana e SUSHN me ush nr.839, datë 27.12.2016 likuiduar firma "Spearkle 32" shpk për shumën 692,400 lekë për blerje aksesorë kontrolli, cipe, aspiratorë kabine, sisteme muzike, mekanizëm i hapjes së derës së katit, rula të shasisë së kabinës dhe vaj hidraulik (

mallra për ashensorë), ku për hapjen e procedurës nuk ka në praktikë argument të nevojës për këto mallra, në një kohë që ishte në zbatim një kontratë e mirëmbajtjes së ashensorëve full risk. Kjo blerje është kryer me blerje shkresore, pasi procedura elektronike dështoi dy herë si rezultat i mos paraqitjes së asnjë ofertuese (citim ky i procesverbalit nr.6 datë 20.12.2016) në zbatim të urdhrave të prokurimit nr.326 dt.30.11.2016 dhe nr.338 dt 06.12.2016. *Nga grupi i auditimit shuma prej 692,400 lekë konsiderohet e pa argumentuar dhe efekt financiar negativ i shkaktuar nga AK (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 189-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Rekomandimi 6**

*Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 692,400 lekë dhe eliminimin e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 7**

-Nga auditimi ka rezultuar se me ur.shp. nr.298, datë 02.05.2017 likuiduar “A” sha në shumën 788,000 lekë në bazë të faturës nr. 615 datë 27.04.2017 për sigurim nga zjarri, rufetë eksploziv të godinave (vetëm si ndërtesë të SUSHN) në bazë të kërkesës së degës teknike dhe miratuar nga titullari me nr. protokollit 132, datë 23.03.2017. Referuar dokumentacionit të kësaj praktike ka rezultuar:

1-Mungon argumentimi i llogaritjes së fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” neni 5 pika 2.

2-Mungon argumentimi i këtij planifikimi për shpenzim (sigurim vetëm i ndërtesave) pasi SUSHN ruhet nga roje private 24 orë në ditë. Ka shpenzime gjatë vitit 2016 për marrje masash për mbrojtje nga zjarri (aparate të shuarjes, plane evakuimi) etj. Gjithashtu theksojmë se në SUSHN ka vlera materiale aparatura, mallra të blera gjatë vitit (barna dhe kite e reagente) objekte inventari që zënë një vlerë të konsiderueshme në AQT të institucionit, ku referuar gjendjes inventariale të fund vitit 2016 kjo gjendje është ndërtesa 1,012,815,200 lekë (kjo shumë është siguruar) kurse aparatura,pajisje në vlerën 1,508,415,649 lekë inventar ekonomik 93,971,789 lekë, mjete transporti 44,658,957, materiale 84,455,206 lekë janë të pasiguruara. Sigurimi i vetëm ndërtesave (ngrehinave si ndërtim) quhet i paargumentuar nga grupi i auditimit, aq më tepër ku referuar kriterëve të mbulimit të policës së sigurimit vetëm 3% dhe vetëm në rastet e specifikuara në policë si dhe referuar objektit që mbulon polica e sigurimit, grupi i auditimit e konsideron shpenzimin prej 788,000 lekë jo efektiv (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 189-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Rekomandimi 7**

*-Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 788,000 lekë dhe eliminimin e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 8**

-Nga auditimi ka rezultuar se me ush.340, datë 23.05.2017 është likuiduar firma “F” shpk në shumën 78,540 lekë për mirëmbajtje ashensori të muajit prill referuar kontratës 8/4 dt.1.02.2017. Referuar situacionit të firmës, në pikën 6 të shërbimeve të kryera theksohet: Pastrimi shërbimi dhe vaisja komplete 1 herë në muaj në vleftën 8,000 lekë (për 2 ashensorë të mëdhenj, 3 me kapacitet 700kg, 2 me kapacitet 370 kg dhe 4 mini ashensorë). Ndërkohë me ush.nr.345 datë 23.05.2017 është likuiduar firma “S” shpk në shumën 116,640 lekë për F.V vaj ashensori në shumën 120 litra. Procedura është realizuar me blerje nën 100,000 lekë. Nuk ka në praktikë dokumentacion që argumenton këtë shpenzim në një kohë që ky shpenzim është pjesë e kontratës së lidhur me nr. 8/4 dt.1.02.2017 me firmën “F” shpk për



mirëmbajtjen ashensorëve. Nga grupi i auditimit *shuma 116,640 lekë konsiderohet shpenzim i mbivendosur dhe jo efektiv pasi kontrata e mirëmbajtjes me nr.8/4 është kontratë shërbimi full risk (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 208-228 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Rekomandimi 8**

*-Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 116,640 lekë dhe eliminimin e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.*

**Menjëherë**

#### **Gjetja nga auditimi 9**

Nga auditimi ka rezultuar se me urdhër shpenzimin nr.326, datë 19.05.2016 likuiduar shuma 10,536,003 leke materiale mjekimi ne bazë të kontratës nr.141/11, datë 05.02.2016 lidhur me Firmën “G”shpk, ku vlefata e kontratës është në shumën 22,600,347 lekë me TVSH. Referuar dokumentacionit të vendosur bashkëlidhur urdhër shpenzimit rezultoi se fatura me nr.34 në shumën 10,536,003 lekë me TVSH mban datën 13.05.2016, ku këtë datë mban dhe procesverbali i dorëzimit dhe fletë hyrja në magazinë. Referuar nenit 3 të kontratës "Kushtet e furnizimit", afati i furnizimit të mallit fillon nga nënshkrimi i kontratës e deri më datën 15.04.2016, pra malli i sipërm ka ardhur me 27 ditë vonesë. Në praktikën e shpenzimit ndodhet kërkesa e operatorit për shtyrje të afatit të furnizimit dhe kjo kërkesë është miratuar nga AK por jo me amendim të kontratës, sipas përcaktimeve në kontratën bazë. Duhet të theksohet se AK këtë kontratë e ka realizuar në kushtet e emergjencës (me negociim pa shpallje paraprake), kështu vendosja apo pranimi i ndryshimeve kohore të dorëzimit të materialeve të mjekimit me një muaj vonesë, kur vetë zbatimi i kontratës kishte afatin e zbatimit prej 2 muaj e 10 ditë, e vë AK në kushtet jo të një emergjence, po në kushte normale të zbatimit të procedurës së hapur të prokurimit publik. *Në këto kushte autoriteti kontraktor nuk duhet të miratonte shtyrjen e afatit, por duhet të llogariste kamat vonesat referuar nenit 3 pika 5 të kontratës, të cilat rezultojnë në vlerën 1,137,888 lekë efekt financiar (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 189-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Rekomandimi 9**

*-Nga AK të merren masa për të analizuar me hollësi shkaqet e shtyrjes së afateve nga operatori ekonomik dhe miratimin e tij jo konform përcaktimeve në kontratë, të cilat do të rezultojnë me penalitet, në një kohë që kjo kontratë është kryer me procedurë negociimi pa shpallje paraprake. Gjithashtu nga AK të mos lejohen në të ardhmen shtyrja e afateve pa shkaqe të parashikuara në aktet ligjore dhe sidomos në kryerjen e shërbimit dhe furnizimit me mallra të prokuruar në kushtet e emergjencës.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 10**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Mirëmbajtje të disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit S”**, zhvilluar në datë 30.12.2016, është konstatuar **efekt negativ financiar në vlerën 3,780,000 lekë**, si rezultat procedurës së zhvilluar në shkelje të nenit 33 të LPP, si dhe kushteve konfuzive të parashikuara në kontratë. Gjithashtu, është vepruar në kundërshtim me nenin 60 të LPP, pasi kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, ku personi përgjegjës është Z. A. I, në cilësinë e menaxhimit të zbatimit të kontratës, si dhe Znj. E. T, në cilësinë e personit përgjegjës të Zyrës Juridike, për hartimin e kushteve konfuzive dhe evazive në kontratë (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 95-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandimi 10**

*Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 3,780,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me*

objekt “Mirëmbajtje të disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit S”, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 11**

Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për dokumentimin dhe qarkullimin e medikamente, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 4,248,445 lekë, si rezultat i marrjes në dorëzim të mallit, në kundërshtim me kushtet e kontratës, si dhe daljes së tij nga magazina e farmacisë, ku personat përgjegjës janë Znj. B. G, Znj. L N, Znj. L. K, në cilësinë e punonjësve të farmacisë dhe marrjes së mallit në dorëzim (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 95-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Rekomandimi 11**

Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën **4,248,445 lekë**, e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në auditimin e ushtruar mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për dokumentimin dhe qarkullimin e medikamente, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 12**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Riparimi tre bronkoskopëve, viti 2016”, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 5,760,000 lekë, e cila përfaqëson shumën e kontratës objekt prokurimi të lidhur ndërmjet AK dhe shoqërisë “M”, si vlerë e investuar në kundërshtim me rregullat, procedurat dhe ligjet, pasi në asnjë rast nuk janë ndjekur procedurat ligjore konform urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë, sipas udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, të Ministrisë së Financave për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, por edhe konform kushteve të kontratës së lidhur midis palëve. Personat përgjegjës janë Znj. E. T me detyrë përgjegjëse e zyrës juridike, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, Znj. E. B me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, Znj. M. F, me detyrë përgjegjëse shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, Z. A. I me detyrë inxhinier biomedical, në cilësinë e anëtarit të njësisë së përllogaritjes së fondit limit dhe të specialistit të fushës, Znj. M.T me detyrë ekonomiste pagash, në cilësinë e anëtarit të njësisë së përllogaritjes së fondit limit, Znj. E. K me detyrë ekonomiste e lartë, në cilësinë e anëtarit të njësisë së përllogaritjes së fondit limit (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 152-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Rekomandimi 12**

Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Riparimi tre bronkoskopëve, viti 2016”, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 13**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje pajisje mjekësore për nevoja spitalore” ndarë në dy lote”, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 3,100,000 lekë, e cila përftohet nga diferenca ndërmjet ofertës së operatorit fitues në vlerën 9,800,000 lekë dhe operatorit me vlerën më të ulët të ofertuar në vlerën 6,700,000 lekë (9,800,000 - 6,700,000), për të cilën ngarkohet me përgjegjësi KVO, konkretisht Z. S. Gj me detyrë përgjegjës i sektorit të financës, Znj. M.F, me detyrë përgjegjëse e shërbimeve dhe Znj. H. D, me detyrë kryeinfermiere e përgjithshme (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 152-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Rekomandimi 13**

*Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 3,100,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Blerje pajisje mjekësore për nevoja spitalore” ndarë në dy lote”, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 14**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje pajisje mjekësore për nevoja spitalore” ndarë në dy lote”, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 2,000,000 lekë, (20% i fondit limit) si rezultat i mos dokumentimit të përlogaritjes së vlerës së fondit limit, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi Znj. E. K, me detyrë ekonomiste e lartë, Znj. M.T, me detyrë ekonomiste pagash dhe Z. A. I, me detyrë inxhinier biomedical (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 152-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandimi 14**

*Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 2,000,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Blerje pajisje mjekësore për nevoja spitalore” ndarë në dy lote”, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 15**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizim-Vendosje mobilim spitalor, viti 2016”, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 3,220,000 lekë e përftuar ndërmjet diferencës së ofertave të dy operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, të cilët kanë dhënë ofertat e tyre për këtë procedurë prokurimi por, që nga verifikimi i dokumentacionit administrativ ligjor, asnjë prej tyre nuk duhet të ishte kualifikuar dhe procedura duhet të anulohet dhe të ribëhet, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi Z. S. Gj me detyrë përgjegjës i financës, Znj. M. F me detyrë përgjegjëse e shërbimeve, si dhe Znj. H. D me detyrë kryeinfermiere e përgjithshme.

#### **Rekomandimi 15**

*Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën prej 3,220,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Furnizim-Vendosje mobilim spitalor, viti 2016”, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.*

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi 16**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje material mjekimi dhe konsumi kirurgjikale MM1 dhe MM2”, është konstatuar efekti financiar në vlerën 137,638 lekë, e cila përfaqëson vlerën shtesë mbi vlerën e fondit limit, ku personat përgjegjës janë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, konkretisht Z. S.Gj, Znj. B. G, Znj. O. D, si dhe Znj. E T, në cilësinë e personit përgjegjës të zyrës juridike dhe të prokurimit (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 152-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandimi 16**

*Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën prej 137,638 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Blerje material mjekimi dhe konsumi kirurgjikale MM1 dhe MM2”, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.*

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 17**

Nga auditimi i procedurës së zbatimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion në S.U. Shefqet Ndroqi për sistemimet e jashtme, kanalizimet, ndriçimi dhe ashensori në godinën e administratës etj, faza III”, sipas kontratës së sipërmarrjes Nr. 724 Prot., datë 30.10.2015, me vlerë kontrate 162,223,281 lekë me TVSH, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën **29,883,935 lekë**, si rezultat i çmimeve të paargumentuara, të pa dokumentuara që ka përcaktuar projektuesi i këtij objekti në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, si dhe në kryerjen e punimeve në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe preventivit fitues, ku personat përgjegjës janë projektuesi i hartimit të projekt-preventivit të objektit, si dhe kontraktori (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 96-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Rekomandimi 17**

Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën prej **29,883,935 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Rikonstruksion në S.U. Shefqet Ndroqi për sistemimet e jashtme, kanalizimet, ndriçimi dhe ashensori në godinën e administratës etj, faza III”, si dhe të të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë**

### **Gjetje nga auditimi 18**

Nga auditimi i procedurës së zbatimit të kontratës me objekt: “Blerje medikamente për vitin, 2016”, me fond limit 28,489,900 lekë pa TVSH, datë zhvillimi 03.02.2016, sipas kontratës së nënshkruar Nr. 159/8 datë 03.02.2016, me kontraktin “M. S” shpk, me ofertën 28,397,877 lekë pa tvsh, me një ulje të papërfillshme nga fondi limit prej **0.32%**, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **2,963,398**, e cila përfaqëson penalitetin e pa mbajtur për vonese në levrimin e mallit, ku personat përgjegjës janë Znj. B. G, Znj. L. N, Znj. L. K, në cilësinë e personave përgjegjës të famacisë, si dhe Znj. E. T në cilësinë e përgjegjëses së sektorit juridik dhe prokurimeve, si dhe shoqëria fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 152-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Rekomandimi 18**

Nga titullari i SUSHN të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën prej **2,963,398 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me efektin negativ financiar që ka sjelle lëvrimi me vonese i mallit për kontratën me objekt “Blerje medikamente për vitin, 2016”.

**Menjëherë**

## **D. MASA DISIPLINORE**

**D.1** Bazuar në nenin nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, “Kontratës kolektive të punës” i kërkojmë Titullarit të SUSHN të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

**“Zbritje në detyrë në një cikël më të ulët për një periudhë deri në një vit” deri në “ largim nga detyra”**

**1. Z. S. Gj** në cilësinë e anëtarit të NJPBVV, Shefit të Financës dhe në pozicionin e N/Z të institucionit.

- Pasi nga auditimi i shërbimeve të mjeteve me vlera të vogla (shkresore) rezultoi se shërbimet kanë tejkaluar limitet e përcaktuara në Vendimin KM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për këtë lloj procedure,
- Gjithashtu ka rezultuar se përcaktimi i fondit limit referuar studimit të tregut, rezulton formal me dokumentacion jo bindës dhe shpesh herë i fryrë ( blerje bojërash plastike, Blerje lulesh dekorative, blerje bojërash për printer dhe fotokopje)
- Për kryerje procedurash të blerjeve me vlera të vogla duke shkelur aktet ligjore ( Udhëzimin e APP nr.3, datë 27.01.2015 neni 5) dhe duke shkaktuar efekte financiare 425,200 lekë.
- Kanë përdorur fonde pa efektivitet për mirëmbajtje ashensorësh në shumë 692,400 lekë dhe Siguracion ndërtesash në shumën 788,000 lekë .
- Ka lejuar së bashku me Nëpunësin autorizues kontraktimin e shërbimeve më shumë se sa kanë qene fondet buxhetore në dispozicion duke shkelur ligjin organik të buxhetit.
- ka tejkaluar afatin një mujor të likuidimit të faturave të operatorëve duke shkelur ligjin nr.9936, datë 26.06.2008” Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 52.
- Për pasaktësitë e rezultuara në hartimin e pasqyrave financiare në lidhje me pasqyrimin e amortizimeve, vlerave për aktivet e dala jashtë përdorimit, kryerjes konform procedurave ligjore të inventarëve, etj (*Mbajtur akt- konstatimi me nr.7 dhe nr.8 , datë 30.03.2018*).
- Për shkeljet në përcaktimin e kriterëve në tenderin “ Mobilim spitalor”, mos argumentim dhe vendosje kriteresh diskriminuese (*Mbajtur akt- konstatimi datë 13.04.2018 dhe trajtim në Raport Përfundimtar faqe 152- 189*).

## **2. Znj. M. F , në cilësinë e anëtarit të NJPBVV.**

- Pasi nga auditimi i shërbimeve të mjeteve me vlera të vogla (shkresore) rezultoi se shërbimet kanë tejkaluar limitet e përcaktuara në Vendimin KM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për këtë lloj procedure,
- Gjithashtu ka rezultuar se përcaktimi i fondit limit referuar studimit të tregut, rezulton formal me dokumentacion jo bindës dhe shpesh herë i fryrë ( blerje bojërash plastike, Blerje lulesh dekorative, blerje bojërash për printer dhe fotokopje)
- Për kryerje procedurash të blerjeve me vlera të vogla duke shkelur aktet ligjore ( Udhëzimin e APP nr.3, datë 27.01.2015 neni 5) dhe duke shkaktuar efekte financiare 425,200 lekë.
- Kanë përdorur fonde pa efektivitet për mirëmbajtje ashensorësh në shumë 692,400 lekë dhe Siguracion ndërtesash në shumën 788,000 lekë .
- Ka lejuar së bashku me Nëpunësin autorizues kontraktimin e shërbimeve më shumë se sa kanë qene fondet buxhetore në dispozicion duke shkelur ligjin organik të buxhetit.
- Për shkeljet në procedurën e prokurimit “ Riparimi i Bronkoskopëve”.
- Për shkeljet në përcaktimin e kriterëve në tenderin “ Mobilim spitalor”, mos argumentim dhe vendosje kriteresh diskriminuese (*Mbajtur akt- konstatimi me nr.7 dhe nr.8 , datë 30.03.2018, akt- konstatimi datë 13.04.2018 dhe trajtim në Raport Përfundimtar faqe 152- 189*).

## **3. Znj. E.T në cilësinë e anëtarit të NJPBVV si dhe në cilësinë e hartueses së kontratave.**

- Pasi nga auditimi i shërbimeve të mjeteve me vlera të vogla (shkresore) rezultoi se shërbimet kanë tejkaluar limitet e përcaktuara në Vendimin KM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për këtë lloj procedure,
- Gjithashtu ka rezultuar se përcaktimi i fondit limit referuar studimit të tregut, rezulton formal me dokumentacion jo bindës dhe shpesh herë i fryrë ( blerje bojërash plastike, Blerje lulesh dekorative, blerje bojërash për printer dhe fotokopje)
- Për kryerje procedurash të blerjeve me vlera të vogla duke shkelur aktet ligjore ( Udhëzimin e APP nr.3, datë 27.01.2015 neni 5) dhe duke shkaktuar efekte financiare 425,200 lekë.
- Kanë përdorur fonde buxhetore pa efektivitet për mirëmbajtje ashensorësh në shumë 692,400 lekë dhe Siguracion ndërtesash në shumën 788,000 lekë.

- për hartimin e kushteve evazive të kontratës në kontratën “Blerje oksigjen i lëngët”

Për hartimin e kushteve konfuze në kontratës “Mirëmbajtje të disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit S”, ku është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 3,780,000 lekë.

-Për shkeljet në procedurën e prokurimit “ Riparimi i Bronkoskopëve”.

- Për shkeljet në përcaktimin e kriterëve në tenderin “ Mobilim spitalor”, mos argumentim dhe vendosje kriteresh diskriminuese (Mbajtur akt - konstatimi nr.7 datë 30.3.2018, mbajtur akt konstatim të datës 13.04.2018, raport përfundimtar faqe 95-189).

**D2.** Bazuar në nenin nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, të ndryshuar, kontratën kolektive të punës, i kërkojmë Titullarit të SUSHN që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

**Nga” Vërejtje me shkrim” deri në” “Zbritje në detyrë në një cikël më të ulët për një periudhë deri në një vit”** Për komisionin e marrjes në dorëzim të barnave Kiteve dhe reagenteve

**4.znj. B.G**

**5.znj. M. P**

**6.znj. L.N**

**7.znj. A. N**

**8.znj. L. K**

**9.znj. D.B**

**10.znj. E. D**

-Pasi gjatë auditimit me zgjedhje të likuidimeve nëpërmjet bankës rezultoi se gjatë vitit 2016 në vlerën 3,108,983 lekë dhe gjatë vitit 2017 në vlerën 838,383 lekë kanë pranuar në cilësinë komisionit të pritjes së mallit barna, kite dhe reagente të cilat e kanë pasur afatin e skadencës më të vogël se 1 vit, veprim që bie në kundërshtim me DST të paraqitura në procedurën e prokurimit si dhe në dokumentet standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe APP (Mbajtur Akt- konstatimi nr.7, datë 30.03.2018).

Gjithashtu për Znj. B G, Znj. L N, Znj. L K, në cilësinë e punonjësve të farmacisë dhe komisionit të marrjes së mallit në dorëzim nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për dokumentimin dhe qarkullimin e medikamente, ngarkohen me përgjegjësi si rezultat i marrjes në dorëzim të mallit, në kundërshtim me kushtet e kontratës. (në këto praktika është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 126,382 lekë dhe efekt financiar në vlerën 4,248,445 lekë)

Gjithashtu kanë përgjegjësinë për mos marrje masash për qarkullimin në kohë dhe mos nxjerrje jashtë përdorimi dhe asgjësimi të medikamentit të skaduar gjendje në farmaci (Mbajtur aktkonstatimet e datës 13.04 2018 si dhe trajtuar gjerësisht në faqet 95- 189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**D3.** Bazuar në nenin nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, të ndryshuar, kontratën kolektive të punës, i kërkojmë Titullarit të SUSHN që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

**“ Vërejtje me shkrim “ për punonjësit**

**1.z. A. I anëtar i NJP**

-Për shkeljet në procedurën e prokurimit “ Riparimi i Bronkoskopëve”, mos argumentimi i llojit të procedurës.

- Për shkeljet në pritjen e mallit të kontratës “ Mobilimi Spitalor”, ku mallrat jashtë kushteve të kontratës (mbajtur akt konstatim të datës 13.04.2018, raport përfundimtar faqe 95-189).

**2.znj. E. B anëtar i NJP**

-Për shkeljet në procedurën e prokurimit “ Riparimi i Bronkoskopëve”.

- Për shkeljet në përcaktimin e kriterëve në tenderin “ Mobilim spitalor”, mos argumentim dhe vendosje kriteresh diskriminuese (*mbajtur akt konstatim të datës 13.04.2018, raport përfundimtar faqe 95-189*).

### **3.znj. M. T anëtar i NJP**

-Për shkeljet në procedurën e prokurimit “ Riparimi i Bronkoskopëve”, mos argumentimi i llojit të procedurës.

- Për shkeljet në procedurën “ Mobilim spitalor”, mos argumentim i fondit limit si anëtare e komisionit të llogaritjes së fondit limit (*mbajtur akt konstatim të datës 13.04.2018, raport përfundimtar faqe 95-189*).

### **4.znj. E. K anëtar i NJP**

-Për shkeljet në procedurën e prokurimit “ Riparimi i Bronkoskopëve” mos argumentimi i llojit të procedurës.

- Për shkeljet në procedurën “ Mobilim spitalor”, mos argumentim i fondit limit si anëtare e komisionit të llogaritjes së fondit limit (*mbajtur akt konstatim të datës 13.04.2018, raport përfundimtar faqe 95-189*).

**D.4** - Bazuar në nenin nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, të ndryshuar, kontratën individuale të punës i ndryshuar, i kërkojmë Titullarit të SUSHN që krahas fillimit të procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e sipërcituar, të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë edhe për punonjësit e tjerë për mangësitë dhe shkeljet e tjera të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit (duke u përqendruar edhe tek praktikat me përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore).

## **F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, Drejtoria e Burimeve njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, ***të ndër marrë veprimet si më poshtë:***

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**

